



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 46 Prot.

Tiranë, më 28.01. 2020
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTUAR: AGJENCISË SE PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

Në zbatim të Vendimit Nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, Urdhërin e Kryeministrit Nr. 171 datë 27.09.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë”, dhe në VKM Nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësme drejtuese”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për **1 (një)** vend të lirë pune në pozicionin: **Specialist pranë Sektorit të Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatit:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master Shkencor ose ekuivalent me të, me formim në një nga fushat: Shkenca sociale dhe/ose shkenca humane;
2. Të zotërojë gjuhën angleze, të certifikuar në një nga testet ndërkombëtare të njohura nga MASR, me dëshmi në nivel mbi mesatar;
3. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë;
4. Preferohen kandidatë të cilët kanë përvojë pune në institucionet e arsimit të lartë ose që kanë lidhje me arsimin e lartë.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatit:

1. Të ketë eksperiencë pune të paktën **5 (pesë)** vjeçare në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri;
2. Të ketë njohuri mbi dhe eksperiencë me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë në Shqipëri;
3. Të ketë njohuri mbi legjislacionin bazë të arsimit të lartë në Shqipëri dhe njohuri mbi institucionet, programet e studimit, procedurat, kriteret dhe aktet nënligjore të vlerësimit të jashtëm të cilësisë;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

4. Të ketë dhe të dëshmojë aftësi të mira shkrimi dhe komunikuese;
5. Të dëshmojë aftësi për të punuar në grup.

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*);
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal;
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar;
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces;
5. Fotokopjen e librezës së punës të noterizuar;
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj të noterizuar;
7. Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të kryera të noterizuara;
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm;
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj të shkuar dhe folur, dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën **10.02.2020**, ora **14:00** në adresën e mëposhtme:

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
Rruga e Durrësit, Nr. 219
Tiranë
(pranë Gjimnazit “Qemal Stafa”)

Njoftimi të bëhet edhe në web site e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë:

www.ascal.al

DREJTORI



Elvin Gjevori

